



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 150/2022

Datë: 20 prill 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), si autoritet kompetent, në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 9 paragrafi 1, pika 1.3, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj z.Enver Pecit, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës sipas ankesës së ushtruar nga në mbledhjen e 283-të, të mbajtur më datë 20 prill 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pa lejuar, ankesa e paraqitur kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme z. Enver Peci, nr.GJS-2022-005, të datës 24.03.2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar nga çerkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës z.Enver Peci, me pretendimin se Aktvendimi GJS-2022-005, i datës 24.03.2022, i nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Supreme, është vazhdim i diskriminimit flagrant, trajtim arbitrar dhe i pa bazuar në ligj sepse nuk ofron siguri juridike dhe trajtim të barabartë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 20 prill 2022, pasi shqyrtoi dhe vlerësoj pretendimet ankimore të vendimit të ankimuar, në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të Ligjit për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve ka gjetur se:

Kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Supreme Enver Peci, e parashtruar nga është e pa lejuar.

Nga shkresat e bashkangjitur kërkesës për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Supreme z.Enver Peci, Këshilli ka konstatuar se parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë tek Kryetari i Gjykatës Supreme, duke pretenduar se Kryetari i Gjykatës së Themelore në ka bërë keqpërdorim të pozitës dhe trajtim arbitrar, në lidhje me kërkesën e ankueses në këtë rast, që i ka paraqitur Kryetarit për gjyqtarin e çështjes e qe si shkas ka qenë vendimin i kryetarit i evidentuar AD.GJTH.GJL.nr.03/2022, më të cilin vendim i është refuzuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit

Kryetari i Gjykatës Supreme z.Peci, duke vendosur mbi ankesën e [] për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në [] të njëjtën e kishte refuzuar si të pabazuar, me arsyetim se pas analizimit të deklaratës se Kryetarit : [], në rastin konkret kishte konstatuar se kërkesa kryesisht ka të bëjë me pretendime të njëjta me kërkesat paraprake për të cilat Kryetari i Gjykatës Supreme ka vendosur me vendimet e evidentuara si: GJS-2020-006, të datës 02.04.2020, GJS-2020-008 dhe GJS-2020-009 të datës 10.07.2020.

Kërkesa e fundit për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetari [] sipas Kryetarit të Gjykatës Supreme nuk ka ofruar ndonjë pretendim apo argument të ri për trajtim, pasi që janë të përsëritura, dhe si të tillë e ka refuzuar si të pa bazuar.

Në këtë drejtim, Ligjit Nr.06/L-057, Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, i ka dhënë mundësin secilit person fizik dhe juridik që të parashtror ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoritet Kompetent, mirëpo nuk ja ka dhënë mundësin ligjore personave fizik dhe juridik që të parashtrorjnë kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore tek Këshilli ndaj Autoritetit Kompetent (Kryetarit të gjykatës) kur Autoriteti Kompetent ka konsumuar shkeljen disiplinore apo ndaj një gjyqtari në situata e paracaktuar ligjërisht, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Në këto rrethana Këshilli, duke vlerësuar ankesën e parashtruar së bashku me shkresat e bashkangjitur sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Supreme me rastin e nxjerrjes se Aktvendimit GJS-2022-005, të datës 24 mars 2022, konstatoj se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Supreme z.Enver Peci është e pa lejuar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.150/2022, datë 20 prill 2022



Albert Zogaj
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

-
- Enver Peci, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Arkivit.